

RELACION TEKNIK

RIKONSTRUKSIONI I SHKOLLES 9 VJEÇARE VELMISH

Shkolla egzistuese ndodhet ne fshatin Velmish - Bashkia Roskovec .
Gjendja egzistuese e shkolles eshte jashte standarteve te zhvillimit te mesimit .

Siperfaqet e mureve te brendeshme ne klasa jane te demtuara ,suvatimi ne disa segmente mungon, muret e tulles jane te demtuara ,tavani ka lageshti dhe ne disa vende pikon,instalimete elektrike tualete jane jashte dhe te demtuara e ,mungojne tualetet ne ambiente te brendeshme te shkolles mungojne ,mungon ndricimi normal ne klasa ,dritaret jane jashte perdorimit ,zgara dritare jane te ndryshkur dhe te demtuara ,shkallet e jashteme jane te ceduara ,shtresa e pllakave eshte e demtuar dhe e ceduar , muret e jashteme jane te demtuara dhe te pasuvatuara nga reshjet jane krijuar ne disa zona gropa.

Soleta eshte pa pjerresi mban lageshtine dhe ehte e mbulluar me dhe dhe me bar ,Mungojne dhe jane te demtuara dyert e klasave ,dera e jashteme eshte jashte perdorimit ,oborri i shkolles eshte me gropa dhe i mbuluar nga ferrat dhe shkurret ,mungon rrethimi i shkolles.

Mungojne tualetet brenda ne shkolle.Mungon terreni sportiv.

Projekti i rikonstrukcionit te shkolles do të bëhet ne ambiente e brendeshme dhe te jashteme .

Ne ambintet e brendeshme do te behet rikonstrukcion i plote i klasave si suvatime shtresa ,dyer dritare ,intalime elektrike ,gjithashtu te kontrollohet edhe mbulimi i objektit pasi soleta eshte e demtuar .

Ne ambientet e jashteme te relizohet sistemimi i oborrit

duke krijuar nje oborr te gjelbëruar me stola dhe kënde pushimi

Sheshi i reshtimit do te përbëhet nje shesh te struar me pllaka te presuara te vendosura mbi rere si dhe ne zonen e hyrjes nga një shtresë asfaltobetoni

Oborri eshte parashikuar te ketë gjelbërimi stola për tu ulur.

I gjithë oborri i shkollës eshte parashikuar te trajtohet duke mos lënë asnjë hapsirë bosh dhe të panevojshme duke e trajtuar dhe me peme të mëdha të vendosura përreth murit rrethues. Muri rrethues do të realizohet nga ana e rrugës me butobeton dhe me kangjella me konfiguracione të cilat me vendojen e pemëve do të mbulohen nga gjelbërimi. Muret dhe kollonat e rrethimit të kenë kapuc të shoqëruar me kanalim me pikore.

Eshte parashikuar te ndertohet nje palester .

Do te ndertohen tualete ne ambientet e brendeshme ne shkolle .Sistemimi dhe reahabilitimi i sheshit te shkolles.

Te dhëna mbi shkollën

Shkolla ka 17 klasa mësimi dhe pa tualete

Do te ndertohen dy nyje hidrosanitare .

Muret e nyjeve hidrosanitare vishen me pllaka majolike deri në lartësinë 2.0 m. Dyert e brendshme të nyjeve hidrosanitare janë me hapsirë 80 cm. Kabinat e WC bëhen me përmasa 1.20 x 1.20 m dhe lartësi 2.2 m. Për larjen e nyjeve hidrosanitare të parashikohen rubinet i vecantë i cili lidhet me tub gome .

SISTEMI I MBROJTES ATMOSFERIKE

Shkolla të ketë sistemin e mbrojtjes atmosferike.

FURNIZIMI ME ENERGJI ELEKTRIKE

Furnizimi me energji elektrike ve, prizave, pajisjeve të laboratoreve, aparaturave të ndryshme etj.

Gjate hartimit të projektit, rekomandohet të respektohet skema skelet e mësipërme ose një skemë e ngjashme.

Rrjeti furnizues perbehet nga linjat kabllore (ose linjat me percjellsa) qe ushqejne kuadrot elektrike te vendosur ne ambientet e ndryshem te shkolles. Ne fillim linjat e rrjetit furnizues vendosen (shtrihen) ne trase fillimisht te perbashket, nga e cila shkeputen linjat dora-dores afrimit te kuadrot elektrike te ambienteve. Trasea, e perbere nga kablllo ose percjellesa te futur ne tuba, rekomandohet te shtrihet ne dyshemene e korridoreve, nen shtresen e pllakave dhe, per linjat e gjata, Tubat e linjave jane plastike, fleksibel, te forte dhe qe nuk perhapin djegjen.

RRJETI ELEKTRIK NE TERESI

KUADROT ELEKTRIKE TE AMBIENTEVE TE SHKOLLES – Kuadrot elektrike jane prej materiali plastik, me mbulese te tejdukeshme dhe per vendosje brenda murit.

LLAMPAT E SINJALIZIMIT - Ne kuader do te kete 3 llampa sinjalizimi 220V modulare per rastet kur ne kuader vjen linje trifazore, dhe 1 llampe ne rastet e linjes furnizuese njefazore.

AUTOMATET - Automati i pare magneto-termik ne kuader do te jete ai i mbrojtjes diferenciale, me rryme ndjeshmerie 30mA, tri ose nje fazor ne varesi te linjes furnizuese, qe perben automatin kryesor mbrojtjes

KUTITE SHPERNDARESE – Ne rrjetin shperndares jane vendosur kuti plastike me kapak, brenda murit, per te lehtesuar shtrirjen e percjellsave, per kontrollet e linjave dhe per degezimet.

Lartesia e vendosjes se kutive te jete 25cm nga dysHEMEja dhe kapaket e tyre nuk duhet te dalin mbi siperfaqen e murit te suvatuar.

TUBAT FLEKSIBEL – Te gjitha linjat shperndarese te jene ne tuba plastike, fleksibel, te forte, prej materiali qe nuk perhap djegjen. Tubat te shtrihen kryesisht ne dysHEMEte e ambienteve, nen pllaka

KUTITE MODULARE PER CELSA E PRIZA – Per montimin e celsave, prizave te te gjitha llojeve dhe pajisjeve te tjera modulare te perdoren gjeresisht kutite plastike 3 moduleshe nen suva.

Lartesia e vendosjes se kutive nga dysHEMEja rekomandohet te jene : 1.1m

PERCJELLSAT DHE KABLOT – Te gjithë percjellsat e rrymes me tension 220/380V jane parashikuar prej bakri shumefijesh, te veshur me nje shtrese izolimi plastike me tension prove 750V.

CELSAT – Te gjithë celsat per drita jane parashikuar modulare, me rryme 10A dhe tension 250V. Per te gjithë instalimin elektrik te shkolles rekomandohet te perdoren celsa te te njejtës seri prodhimidhe te te njejtës ngjyre.

PRIZAT 220V - Prizat e fuqise, parashikohen per te gjithë shkollen, jane dymoduleshe (tipi 'shuko universale'), me rryme nominale 16A dhe tension 250V, me tokezim. Pjesa tjetër e prizave jane njemoduleshe, gjithashtu 16A dhe

250V me tokezim (tipi i ashtuquajtur 'bivalente'). Jane parashikuar kutite 3 moduleshe ku kerkohet vendosja e nje celesi dhe e nje prize, priza te jete e tipit 'shuko'.

NDRICIMI

Ndricimi i ambienteve te shkolles – klasave, laboratoreve, dhomave te punes, kabineteve, zyrave te drejtorise dhe te trupit mesimor, etj, si dhe i sallave dhe terreneve te aktiviteteteve sportive – perben nje pjese shume te rendesishme te punes projektuese elektrike.

NDRICIMI I BRENDSEHEM -

Ndricimi i ambienteve te brendshem jane :

1. klasat, duke perfshire edhe drrasat e shkrimit, 2*58w luminishent
2. Korridori, nyjet sanitare, 2*18 W

Linjat shperndarese per klasat mesimore jane si vijon : Seksioni i percjellsave per prizat mbetet 3x2,5mm² ne tuba pvc fi20mm, ndersa per ndricuesat degezi-me 3x1,5mm² ne tuba pvc fi16mm.

NDRICIMI I OBORRIT TE PERPARME

Ndricimi i oborrit parashikohet ne ne zonen perpara hyrjes ne ndertesen e shkolles

Linja e ndricimit te oborrit jane te vecanta nga ajo e furnizimit te brendshem, ushqehen nga kuadri elektrik i jashtem.

DETEKTIMI I ZJARRIT DHE SISTEMI I ALARMIT

Ne projektin elektrik te shkolles perfshihet instalimi i detektoreve te zjarrit dhe, sistemi i alarmit .

Ne sistemin e detektimit (zbulimit) pervec detektoreve, qe zbulojne automatikisht fenomenin, edhe paneli kryesor i kontrollit dhe komandimit, ku perqendrohen informacionet qe vine nga detektoret, ku behet identifikimi i vendit ku ka filluar nje zjarr (ose me heret, tymi i ketij zjarri) dhe prej ku leshohen sinjalet e alarmit me ndezjen e ndricuesave te vecante per kete qellim e njekohesisht me ze

MBROJTJA NGA GODITJET E RRUFESE, TOKEZIMI DHE MATJA E ENERGJISE

Mbrojtja nga goditjet e rrufese eshte e domosdoshme per shkak te kushteve atmosferike te vendit tone dhe se ndertesat shkollore bejne pjese ne kategorie e ndertesave qe duhet te mbrohen.

Mbrojtja atmosferike fillon nga ose catia e nderteses shkollore me vendosjen e shirita-ve prej hekuri te zinguar me seksion 30x3mm gjate parapetit perimetral (konturi rrufeprites), ne te cilin saldohen shtiza te shkurtera, rreth 60cm, me maje, ne pikat me te ekspozuara, sic jane kthesat dhe oxhakët (nese ka te tille). me saldim).

Ne cdo elektrode tokezimi eshte vensosur nje pusete me permasa 40x40cm, me thellesi 50cm dhe kapak gize, per te kontrolluar periodikisht gjendjen e lidhjes metalike te zbritesave me elektrodën perkatëse (pra dhe konturin tokezues)

percjellesa.

Seksioni minimal i percjellesit mbrojtës eshte 1 baker per nje ndricues

Matja e konsumit te energjise elektrike te shkolles te kryhet sipas kerkesave dhe

INSTALIMET HIDRAULIKE

Furnizimi me ujë të parashikohet i pandërprerë duke parashikuar marrjen e ujit nga depo qe eshte ne distancën rreth 100 ml nga shkolla Materialet hidraulike për sistemin e ujit të pijshëm dhe atë të ujrave të zeza të kenë cilësinë e kohëzgjatjes , izolimin e mjaftueshëm dhe ti rezistojnë veprimeve mekanike , kimike , termike dhe lagështirës.

PUSETAT E INSTALIMEVE KANALIZIMET

Per largimin e ujrave te zeza nga ambiente e tualeteve behet me tubo plastike per ne puseten kryesore te shkarkimit ,nga puseta per ne gropen septike behet me tubo betoni 200 mm.

SISTEMIMET E JASHTME,

Sistemimit të oborrit është ndarë ne ambiente të cilat do të shërbejnë për qëndrim e shlodhje dhe ambientet sportive të cilat shërbejnë për kryerjen e lëndës së edukimit fizik në shkollë.

Taraca

Eshte parashikuar hidroizolimi i taraces .

NDERTIMI I PALESTRES .

Eshte parashikua ndertimit i nje palestres per kryerjen e aktiviteteve sportive te shkolles.

Palestra do te ndertohet me mure tulle si dhe mbulese me kapriata metalike si dhe mbulimi do te realizohet me sandwic.

PROJEKTUESI

' E R S I ' SHPK

ADMINISTRATORI

ING.GEZIM GOXHAI

